



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.16/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KQZ për anulimin e vendimit Nr.01/2328/2024, të datës 31.12.2024, në seancën e panelit të mbajtur me datë, 09.01.2025, mori këtë

V E N D I M

HUDHET poshtë e palejuar ankesa Anr.16/2025, e datës;08.01.2025, e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KQZ, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi i KQZ-së Nr.01/2328-2024, i datës;31.12.2024, dhe të urdhërohet KQZ, të nxjerr vendim.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 08.01.2025, ka pranuar një ankesë përmes postës nga Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, me të cilën thekson se me datë 25.12.2024, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (më tej PZAP) ka marrë vendim A.nr.12/2024, me të cilën në pikën II të dispozitivit të saj urdhëron KQZ-në, ta certifikojë Listën Serbe sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim, ndërsa me datë 31.12.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka mbajtur mbledhjen e radhës lidhur me mundësinë dhe mënyrën e zbatimit të vendimit të PZAP-së., dhe në këtë mbledhje nuk ishte arritur që mbi bazën e legjislacionit në fuqi të votohet për zbatimin e pikës II të dispozitivit të Vendimit Anr. 12/2024 të PZAP-së. Me tutje parashtruesi i ankesës në lidhje me këtë thekson se Kryesuesi i KQZ-së, duke e parë mundësinë jo ekzistuese që të hidhet në votim rekomandimi i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim për subjektin politik përkatës dhe njëkohësisht të zbatohet konkretisht pika II e dispozitivit të Vendimit Anr. 12/2024 të PZAP-së, ka nxjerrë pa asnjë bazë ligjore adekuate dhe në mënyrë in kompetente Vendimin Nr.01/2328-2024, të KQZ-së, me të cilin zbaton Vendimin Anr. 12/2024 të PZAP-së. Lidhur me legjitimitetin e palës, pala ankuese thekson se sipas nenit 139 par.4 i Kushtetutës, lidhur me nenin 61 par.4 nën paragrafi 4.1, të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, subjekti Politik Lëvizja VETËVENDOSJE! përfaqësohet me dy anëtarë në institucionin kushtetues, siç është KQZ. Gjithashtu në nenin 63 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme përcaktohet kuorumi i të pranishmëve dhe i marrjes

së vendimeve. Në rastin konkret, Kryesuesi i KQZ-së, dy përfaqësuesve të Lëvizjes VETËVENDOSJE! ua ka mohuar të drejtën e votimit (e drejta e votimit) si kategori ligjore mbi bazën e të cilës merren të gjitha vendimet në mbledhjet e KQZ-së si organ kushtetues. Me tutje në ankesë theksohet se sa i përket pretendimeve në argumentim ligjor të çështjes kontestuese, neni 63 i LZP-së, përcakton marrjen e vendimeve nga anëtarët e KQZ-së, në mbledhjen e KQZ-së, duke përfshirë se " Takimet e KQZ-së i thërret Kryesuesi ose së paku katër (4) anëtarë, konkretisht paragrafi 3 i nenit 63 thekson se "Takimet e KQZ-së vlejné vetëm nëse në to marrin pjesë jo më pak se shtatë (7) anëtarë të KQZ-së". Në paragrafin 4 të po këtij neni përcaktohet se "Për Rregullat Zgjedhore, regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e partive politike, shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve, si dhe për vendimet lidhur me ankesat që kanë të bëjnë me shpalljen e rezultateve, KQZ-ja vendos me konsensus, përveç kur kjo është e pamundur, atëherë vendoset me dy të tretat (2/3) e votave. Çdo vendim tjetër merret me shumicën e thjeshtë të votave . Ndërsa në paragrafin 5, përcaktohet se "Takimet i kryeson Kryesuesi i KQZ-së. Po ashtu, në paragrafin 11 të po këtij neni theksohet se "Të gjitha vendimet e KQZ-së janë dokumente publike dhe sigurojnë përmbushjen e elementeve të aktit administrativ, siç përcaktohet në ligjin në fuqi për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kryesuesi i KQZ-së ka nxjerrë Vendimin Nr.01/2328-2024, të KQZ-së duke mos e përfillur drejt asnjë nga paragrafët e sipërcituar. Për më tepër, në shpërputhje të plotë me faktet dhe provat notore në preambulën e Vendimit Nr.01/2328-2024, të KQZ-së, theksohet se "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në pajtim me autorizimet e dhëna nga paragrafi 4 i nenit 63, paragrafit 5 të nenit 17, të LZP-së dhe në bazë Vendimit të PZAP-së ka marrë vendimin përkatës lidhur me zbatimin e vendimit Anr 12/2024 të PZAP-së". Parashtruesi i ankesës pretendon se nuk ka pasur konsensus e as votim për nxjerrjen e vendimit të KQZ-së, me të cilin do të zbatohet vendimi i PZAP-së, në kuptim të nenit 118 par.5 të LZP-së, duke pretenduar që kryesuesi gabimisht është bazuar në nenin përkatës që krijon një situatë juridike e cila nuk ka ndodhur siç është parashikuar me ligj të ndodhë. Mbi këtë situatë të paqenë, Kryesuesi i KQZ-së, në mënyrë jo kompetente dhe në kundërshtim flagrant me ligjin përkatës ka nxjerrë Vendimin Nr.01/2328-2024, të KQZ-së, i cili është në kundërshtim me paragrafin 4 dhe 11 të nenit 63 të LZP-së, në ndërlidhje me nenin 48 (mosplotësim i kriterëve) dhe në lidhje me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Parashtruesi i ankesës edhe një herë kërkon nga PZAP-i, që në bazë të nenit 118 të LZP-së në lidhje me nenin 53 par.1 dhe nenin 131 par.4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që brenda afatit ligjor dhe në përputhje me pretendimet e shprehura më lartë lidhur me natyrën e kësaj çështje të anulojë Vendimin Nr.01/2328-2024 të datës 31.12.2024 të KQZ-së, dhe të Urdhërohet KQZ-ja, të nxjerrë Vendimin në përputhje me nenin 63 të LZP-së.

PZAP, iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje KQZ-së, me datë 08.01.2015, lidhur me ankesën A.nr.16/2024, të parashtruar nga ankuesi Lëvizja Vetëvendosje, LVV. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 08.01.2025, ka parashtruar në PZAP, përgjigje në kërkesë, në të cilën theksohet se: Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP) ka bërë rekomandim me shkrim KQZ-së, në mbledhjen e KQZ-së, nr.70/2024 të datës 23.12.2024, Zyra ka rekomanduar për certifikim për zgjedhjet e datës 09.02.2025, subjektin politik Srpska Lista me gjithsejtë 48 kandidatë. Rekomandimi i zyrës ka përmbajtur shpjegimin e shkruar për secilin kriter ligjor të përmbushur nga aplikuesi,

respektivisht subjekti politik Srpska Lista. Pas, diskutimeve të shumta në këtë takim, KQZ, në mungesë të konsensusit për marrjen e vendimit, dhe duke mos arritur 2/3 e votave për miratim dhe rekomandim të Zyrës, nuk e ka certifikuar subjektin politik Srpska Lista dhe kandidatëve të saj. Po ashtu në përgjigje në kërkesë thuhet se, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Srpska Lista, PZAP ka marr vendim A.nr.12/2024 të datës 25.12.2024, me të cilin vendim e ka urdhëruar KQZ, që të certifikoj subjektin politik në fjalë. Pas pranimit të Aktvendimit të Gjykatës Supreme KQZ, ka mbajtur mbledhje për zbatimin e vendimit të plotfuqishëm të PZAP, respektivisht ku KQZ është urdhëruar të certifikoj subjektin politik Srpska Lista. Në këtë takim nuk është votuar certifikimi i subjektit politik në fjalë, sepse kishte urdhër nga një vendim gjyqësor përfundimtar dhe se KQZ ka zbatuar vetëm vendimin e një instance më të lartë. Sipas nenit 118 par. 5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, vendimet e PZAP janë të detyrueshme për tu zbatuar nga ana e KQZ, përveç nëse Gjykata Supreme vendos ndryshe. Në rastin konkret Gjykata Supreme e ka vërtetuar vendimin e PZAP, andaj vendimi i PZAP duhej të zbatohet dhe për këtë nuk ka nevojë për ndonjë votim, kjo për faktin se çështja e certifikimit, respektivisht rekomandimi për certifikimin e subjektit politik Srpska Lista është votuar një herë dhe nuk ka kaluar me votim, ndërsa PZAP me vendimin e saj ka urdhëruar KQZ-në, që të certifikoj subjektin në fjalë, andaj nuk ka pse të votohet një proces i votimit i cili është konsumuar tani, por vetëm duhej të zbatohet vendimi i një instance më të lartë-PZAP. Andaj, KQZ, nuk ka bërë shkelje të ndonjë dispozite ligjore me këtë vendim, përkundrazi, ka zbatuar drejtë ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe po ashtu ka zbatuar vendimet e instancave më të larta lidhur me këtë çështje, thuhet në përgjigjen në kërkesë. Në anën tjetër duke u nisur nga aktvendimi i lartcekur i Gjykatës Supreme të Kosovës AA.nr.60/2024 e datës 30.12.2024, është e qartë se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje nuk mund të parashtrij ankesë ndaj këtij vendimi, pasi që vendimi i atakuar nuk prek ndonjë të drejtë themelore të ankuesit. Andaj, konsideroj se ankesa e parashtruar ndaj vendimit të KQZ të datës 31.12.2024 duhet të hudhet si e palejuar, theksohet në përgjigje të KQZ-së.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se njëjta është e palejuar.

Për të vlerësuar lejueshmërinë e ankesë, Paneli i'u referua Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119.3, i cili nen përcakton se *“PZAP-ja vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.”* Po ashtu Paneli iu referua edhe Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurën e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave, përkatësisht, nenit 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, të saj, i cili përcakton se *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbushë kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: ankesa nuk është parashtruar nga personi me të drejtë ankesë.”*

Sipas vlerësimit të Panelit me vendimin kontestues të KQZ-së palës ankuese nuk i është cenuar ndonjë interes ligjor i paraparë me Ligjin nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, apo aktet nënligjore të nxjerra nga KQZ, e rrjedhimisht nga kjo edhe ankesa është e palejuar.

Lidhur me pretendimin e palës ankuese në ankesë *“se në rastin konkret, Kryesuesi i KQZ-së, dy përfaqësuesve të Lëvizjes VETËVENDOSJE! ua ka mohuar të drejtën e votimit (e drejta e votimit) si kategori ligjore mbi bazën e të cilës merren të gjitha vendimet në mbledhjet e*

KQZ-së si organ kushtetues...” Paneli vlerëson se përfaqësuesit e LV të cilët e përfaqësojnë palën ankuese në KQZ kanë mundur vet të ushtrojnë ankesë kundër vendimit kontestues, dhe se në asnjë rrethanë kjo e drejtë nuk mund të bartet të subjekti politik që ata e përfaqësojnë, çështje kjo e normuar me nenin 124 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili nen përcakton se “1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtarë i një organi kolegjial, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjial, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë.

Nga interpretimi i drejtë i kësaj dispozite ligjore, paneli vlerëson se vetëm dy përfaqësuesit e palës ankuese që janë anëtar në KQZ, nëse pretendojnë se me vendimin kontestues iu është cenuar ndonjë e drejtë e njohur nga Ligji nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, apo aktet nënligjore të nxjerra nga KQZ, mund të ushtrojnë mjete juridike, përkatësisht të kërkojnë mbrojtje për të drejtat e cenuara.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 119 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.16/2025 më datën 09.01.2025

Kryesues i Panelit
Hajriz Hoti



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.